



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KRYEMINISTRI

URDHER

Nr. 156, date 27.12. 2008

PËR
NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDERINSTITUCIONAL TE PUNES,
PER NDJEKJEN E PROCEDURAVE TE KANDIDIMIT TE SHQIPERISE NE NISMEN
PER TRANSPARENCE NE INDUSTRIE NXJERRESE (EITI).

Ne mbështetje te pikes 3 te nenit 102 te Kushtetutës, dhe te pikes 1, te nenit 12 te ligjit Nr. 9000, date 30.01.2003, “ Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave”,

URDHEROJ :

1. Ngritjen e grupit nderinstitucional te punes per ndjekjen e procedurave te kandidimit te Shqiperise si vend zbatues i nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrese.
2. Grupi i punes te kryesohet nga ZevendesMinistri i Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes dhe ne perberje te kete keta anetare.
 - a) Dy perfaqses nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes
 - b) Nje perfaqses nga Ministria e Financave
 - c) Nje perfaqses nga Ministria e Jashtme
 - d) Nje perfaqses nga Ministria e Drejtesise
 - e) Nje perfaqses nga Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta
 - f) Nje perfaqses nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
 - g) Nje perfaqses nga Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave
 - h) Nje perfaqses nga Instituti i Statistikes
 - i) Nje perfaqses nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore
 - j) Nje perfaqses nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar
 - k) Nje perfaqses nga Agjencia e Trajtimit te Koncesioneve

3. Me ftese te kryetarit te grupit ne mbledhjet e ketij grupi mund te marrin pjese perfaqesues nga organizatat jofitimprurese, Banka e Shqiperise, Enti Regullator i Energjise, Grupet e interesit, Bashkimi i Dhomave te Tregetise dhe Industrise.
4. Grupi nderinstitucional i punes te marre masat per realizimin e planit te veprimit dhe te pergatise te gjithë dokumentacionin e nevojshem per te realizuar fillimin e procesit te anetaresimit te Shqiperise, si vend zbatues i kesaj nisme, ne konferencen nderkombetare te Nismes se Transparences per Industrite Nxjerrese qe do te mbahet ne DOHA ne daten 16-17 Shkurt 2009.
5. Grupi nderinstitucional i punes te marr masat per realizimin e planit te veprimit dhe te pergatis te gjithë dokumentacionin e nevojshem per realizimin e anetaresimit te Shqiperise me te drejta e plota te vendit zbatues te kesaj nisme.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA